

VENDIM
Nr. 971, datë 2.12.2015

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR E KULLOSOR PUBLIK DHE PAKËSIMIN NË
VOLUM TË SIPËRFAQES NË EKONOMITË PYJORE “TUÇ”, “LUMBARDHË” E
“LUMI I ZI”, TË QARKUT TË SHKODRËS, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA
“MC INERTE LUMZI” SHPK PËR NDËRTIMIN E HEC “LUMZI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike, prej 237 665 (dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) ha, në ngastrat 5c, 7a, 12, 16a dhe 17b, të ekonomisë pyjore “Tuç”; në ngastrat 9b, 16a, 64a, 65a, 123b, 124a, 125a, 126a dhe 127a, të ekonomisë pyjore “Lumbardhë”; dhe në ngastrat 6b, 23b, 24b, 25 e 26b, të ekonomisë pyjore “Lumi i Zi”, në qarkun e Shkodrës, që do të përdoret nga shoqëria “Mc Inerte Lumzi” sh.p.k., për ndërtimin e HEC “Lumzi”, të hiqet nga fondi pyjor e kullosor publik dhe të pakësohet në volum, sipas lidhjes 1, me të dhënat për ngastrat pyjore dhe hartës topografike, me gjurmën e ndërtimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit të sipërfaqes dhe të volumit të lëndës drusore të paguhen nga shoqëria “Mc Inerte Lumzi” sh.p.k., në bazë të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Mc Inerte Lumzi” sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen pyjore, sipas përcaktimeve në planin e rehabilitimit dhe kushteve të lejes mjedisore, dhe, brenda 5 viteve, të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe prej 71.3 ha fond pyjor, në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit.

4. Ministria e Mjedisit dhe shoqëria “Mc Inerte Lumzi” sh.p.k. të nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët për hapat, afatet dhe procedurat për realizimin e detyrimeve, sipas përcaktimit në pikën 3 të këtij vendimi.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

6. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të bëjë çregjistrimin e sipërfaqes pyjore, të identifikuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore/kullosore” dhe ta regjistrojë atë në kategorinë “Tokë e zënë, objekt i ndërtimit të HEC “Lumzi””.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, shoqëria “Mc Inerte Lumzi” sh.p.k. dhe njësia e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**LISTA E NGASTRAVE DHE E NËNNGASTRAVE QË HIQEN NGA FONDI PYJOR DHE
KULLOSOR PUBLIK PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “LUMZI”
NË QARKUN SHKODËR**

Lidhja 1

<i>ID Pronës</i>	<i>Ekon.Pyjore</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe hiqet (ha)</i>	<i>Perdorimi territorit</i>
Sh 73 00 005c	Tuç	5/c	Ministria e Mjedisit	0.174	Trungishte
Sh 73 000 07a	Tuç	7/a	Ministria e Mjedisit	0.0018	Trungishte
Sh 73 00 012	Tuç	12	Ministria e Mjedisit	0.2075	Trungishte
Sh 73 00 016a	Tuç	16/a	Ministria e Mjedisit	0.0837	Trungishte
Sh 73 00 017/b	Tuç	17b	Ministria e Mjedisit	0.1426	Trungishte
Sh 51 00 009b	Lumbardhe	9/b	Ministria e Mjedisit	4.5743	Trungishte
Sh 51 00 016a	Lumbardhe	16/a	Komuna Qafe-Mali	0.1726	Trungishte
Sh 51 00 064a	Lumbardhe	64/a	Komuna Qafe-Mali	0.1883	Trungishte
Sh 51 00 065a	Lumbardhe	65/a	Komuna Qafe-Mali	0.0703	Trungishte
Sh 51 00 123b	Lumbardhe	123/b	Komuna Qafe-Mali	0.6753	Trungishte
Sh 51 00 0124a	Lumbardhe	124/a	Ministria e Mjedisit	0.3481	Trungishte
Sh 51 00 125a	Lumbardhe	125/a	Ministria e Mjedisit	0.0009	Trungishte
Sh 51 00 126a	Lumbardhe	126/a	Ministria e Mjedisit	0.0018	Trungishte
Sh 51 00 127a	Lumbardhe	127/a	Ministria e Mjedisit	0.0036	Trungishte
Sh 51 00 006b	Lumi i Zi	6/b	Ministria e Mjedisit	0.1762	Trungishte
Sh 53 00 023b	Lumi i Zi	23/b	Bashkia Fushe-Arrez	4.7019	Trungishte
Sh 53 00 024b	Lumi i Zi	24/b	Bashkia Fushe-Arrez	3.8987	Trungishte
Sh 53 00 025	Lumi i Zi	25	Bashkia Fushe-Arrez	7.0536	Trungishte
Sh 53 00 026b	Lumi i Zi	26/b	Bashkia Fushe-Arrez	1.2913	Trungishte
	Gjithsejt			23.7665	

